




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 412/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Ve - Mor” shpk - Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Toifor”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve ne qytetin e Prishtinës” Lot II me nr. të prokurimit: 616-18-421-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datë: 06.09.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Ve - Mor” shpk - Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës” Lot II me nr. të prokurimit: 616-18-421-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin: “Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve ne qytetin e Prishtinës” Lot II me nr. të prokurimit: 616-18-421-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Ve - Mor” shpk - Pejë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 29.03.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 23.04.2018, ku kanë marrë pjesë tetë (8) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik: “Ve - Mor” shpk - Pejë, si tenderues i pasuksesshëm nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 27.07.2018.

Njoftimi për dhënien e kontratës nga Autoriteti Kontraktues është bërë me dt: 27.07.2018.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik: “Ve - Mor” shpk - Pejë, me dt: 01.08.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 03.08.2018, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: “Ve - Mor” shpk - Pejë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: “Ve - Mor” shpk - Pejë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 13 Gusht 2018, me nr. 412/18, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës” Lot II me nr. të prokurimit: 616-18-421-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 paragrafi 1.2.3, nenin 6 par. 1 nenin 7 par. 1.2.4, nenin 56, nenin 59 par. 4, nenin 60 par. 1, nenin 72, nenin 61, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 4.4 të RRUOP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.08.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-profesional, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 24.08.2018, sqaron se bazuar në pretendimin ankimor neni 1 par.1,2,3 i LPP-së (Qëllimi) Paragrafi 1 i nenit 1 citim: “Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla”.

Bazuar në pretendimin e lartshënuar ne si ekspert konstatojmë se AK ka shpallur ofertën me çmimin më të lirë dhe OE i propozuar ka çmimin 119,882.99 €, kurse OE ankues ka çmimin 245,966.49, apo 126,083.50 € (më i lirë se OE ankues). Pra edhe neni 6 – ekonomikiteti dhe efikasiteti, par.1 Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Neni 7 – Barazia në trajtim-jo diskriminimi, citim: *1.Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

2.Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. 4.Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Pra, AK ka përzgjedhur OE “Toifor” për LOT 2, pasi që kishte çmimin më të lirë me dokumentacion të përgjegjshëm. AK i ka trajtuar të gjithë OE sipas nenit 7 të LPP-së, duke i trajtuar të barabartë. Në këtë rast AK ka shpërblyer OE me çmim më të lirë duke u bazuar në nenin 1 dhe 6 të LPP-së, AK ka shpërblyer OE me çmimin dukshëm më të lirë (126,083.50 €) se ankuesi. Pretendimi ankimor i pabazuar.

Eksperti shqyrtues i OSHP-së, lidhur me pretendimin ankimor shkelja e nenit 61 të LPP-së, sqaron se OE duhet të trajtohet si çmim jo-normalisht i ulët sqaron: *Bazuar ne Neni 61 (Tenderet Jo-normalisht te Ulët) dhe Rregullat për Tender Jo-normalisht i ulet, dhe pretendimi i OE ankues se OE i rekomanduar ka çmim jo-normalisht të ulët.*

Sqarim: Tabela në vijim është si duhet të llogaritet formula:

Nr.	Lot 2			
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i parë sepse janë pranuar 7 oferta	Pranuar 7 oferta		Fitues
2	NPN. "Dardania"	1	161,616.17	LOT 3
3	"Toifor" shpk	2	119,882.99	LOT 2
4	"VZ company"	3	132,374.34	LOT 1
5	"Ve Mor" shpk	4	245,966.49	
6	"Pastrimi" sh.a	5	246,730.53	LOT 6
7	"Niti-N" shpk	6	185,515.52	LOT 4
	NTSH "Zahiri"	7	216,361.00	LOT 5
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7+C8)	1,339,350.04	
9		mesatarja (C8/6)	191,335.72	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	147,181.32	ne ketë rast vetëm oferta 2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	223,606.90	ne ketë rast oferta 2 përmbush edhe kushtin e trete

Pretendimi ankimor për shkeljen e nenit 61 të LPP-së, qëndron pasi që në njërin kriter (Rregullat për Tender Jo-Normalisht të Ulët- Version i korrigjuar), del që OE i propozuar ka çmimin si Jo-Normalisht të Ulet. OE ankues radhitet i gjashti (6) me çmim 245,966.49 €, andaj Komuna e Prishtinës edhe pse me çmim dukshëm më të lirë ka vendosur të shpërblej me kontratë OE. "Toifor" Prishtinë me çmim 119,882.99 €.

Sipas nenit 61 të LPP-së, dhe Rregullave për Tender jo-normalisht të ulët – versioni i korrigjuar neni 1;3 dhe 4 (Legjislacioni sekondar). Edhe nëse oferta ka çmim jo-normalisht të ulët AK, duhet ti dërgoj kërkesë për sqarim se a ju qëndron mbrapa çmimeve të dhëna ku sipas nenit 61 paragrafi 1,2, 3 dhe 4. Paragrafi 3 i nenit 61 citim: "Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë" Paragrafi 4 i nenit 61 citim: "Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin". Pra, AK është pajtuar sipas paragrafit 3 të nenit 61 të LPP-së.

PYETJA E AK-KK.PRISHTINE PËR OE.TE REKOMANDUAR AK-Komuna e Prishtinës me dt. 23.07.2018 i ka dërguar e-mail OE së rekomanduar në lidhje me “Tenderët jo-Normalisht të Ulët andaj bazuar në nenin 30.4 të RrUOPP-së, rrit përqindjen e kërkuare sigurimit të ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shpëputet kontrata. Komisioni i vlerësimit beson se ju keni dorëzuar tender jo-normalisht të ulët andaj në përputhje me nenin 30.4 të RRUOPP rrit përqindjen e kërkuar të sigurisë së ekzekutimit nga 10% e vlerës së kontratës në 30% të vlerës së kontratës.

PERGJIGJE E OE SE REKOMANDUAR “Toifor” sh.p.k. OE i rekomanduar me datë 23.07.2018 i ka kthyer përgjigje AK-KK. PRISHTINE, ku thotë se (citim): *“Deklarojmë se në rast se shpërblehemi me kontratë kompania jonë TOIFOR sh.p.k. do të dorëzoj sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 30% të vlerës së kontratës në ditën e nënshkrimit të kontratës”* Pra, sipas kësaj pyetje AK dakordohet se OE i rekomanduar ka çmim jo-normalisht të ulët, sipas nenit 61 të LPP-se, por bindet se OE i rekomanduar do të përfundoj punimet sipas paramases, pra AK pajtohet sipas nenit 61, paragrafi 3 të këtij neni. Pretendimi ankimor pjesërisht i bazuar.

Eksperti shqyrtues i OSHP-së, bazuar në Pretendimin e OE ankues “Ve-Mor” është se OE i rekomanduar për kontratë “Toifor”, duhet t’i ketë 30 punëtor fizik, dhe një inxhinier (dmth. gjithsejtë 31 punëtorë), ku sipas kalkulimit që ka bërë OE ankues, që paga mesatare për një të punësuarit është 210 €, ka bërë kalkulimin për 18 muaj (31 punëtorë x 210 € x 18 muaj =117,180 €)

Çmimi ofertues i OE “Toifor” është 119,882.99 € minus shpenzimet sipas pretenduesit ankimor 117,180.00 €, mbetja për derivate të makinerisë është 2,702.99 € për 18 muaj apo 150.17 €/muaj.

Sqarim i ekspertit: Sa i përket çmimit të dhënë këtë obligim e ka Autoriteti Kontraktues i ka analizuar të gjitha shpenzimet e OE së rekomanduar pasi që i ka pasur në Ekspertizën 223/18 që ti kalkuloj dhe me pajtimin e dyja palëve AK dhe OE së rekomanduar të qartësohet, shihet se pajtohen me këtë çmim ofertues të dy palët OE dhe AK, ku këtë AK e ka sqaruar edhe në Raportin e ri-vlerësimit, ku në faqe 12 thotë: OE pajtohet që të ekzekutoj projektin me çmimin e ofertuar. AK në fazën e rivlerësimit i bën pyetje OE se rekomanduar në lidhje me “Tenderin jo-normalisht të ulët”, kurse OE i rekomanduar me dt.04.07.2018 e kthen sqarimin se: i qëndrojmë mbrapa të gjitha çmimeve. Në shkresën e dërguar nga OE i rekomanduar me titull “INFORMATË” thotë (citim):

“Toifor” shpk ka qenë zbatues i kontratës së datës 14.05.2015 me Komunën e Prishtinës me titull: “Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve të qytetit – pjesa e tretë”, nr.616 15 022 211. Kontrata është kryer në përputhje me kërkesat e saj dhe është realizuar në sezonën përkatëse prej 14.05.2015 deri 15.11.2017...etj
Ne i qëndrojmë mbrapa çmimeve të ofertuara dhe zotohemi se do të kryejmë punimet sipas ofertës dhe

kushteve të kontratës. Pra, AK bindet se OE i rekomanduar do ta ekzekutoj projektin sipas çmimit të ofruar. Pra paragrafi 3 i nenit 61 të LPP-së, thotë (citim); Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë. Pra, bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 ngel obligim dhe përgjegjësi e AK-së. Pas rivlerësimit AK e ka trajtuar OE ankues si OE të përgjegjshëm (Letra standarde dhe Raporti i vlerësimit), por me çmim më të shtrenjtë. Pra, e ka shpërblyer me kontratë OE. "Toifor" me çmim 119,882.99 €.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet ankimore), propozojmë që sipas sqarimeve dhe bindjes se AK-së, sipas nenit 61 të LPP-së të mbetet në fuqi vendimi i AK-Komuna e Prishtinës.

Operatori ekonomik ankues: "Ve - Mor" shpk - Pejë, me datë: 03.09.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 06.09.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti shqyrtues- profesional OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Bajrami deklaroj: Ne si OE nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit dhe vendimin e AK-së dhe mbesim pranë ankesës së parashtruar. OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm Toiforr sepse ka ofrua çmim jo normalisht të ulët, dhe janë plotësuar gjitha kushtet sipas rregullave për tender jo normalisht të ulët, sepse oferta është 30% më e ulët se mesatarja e ofertave tjera, ku pragu ka qenë 147,181.32€, ndërsa OE Toifor ka ofertuar 119,882.99€, që i bie se ka ofertua nën pragu e 30%. AK në rivlerësim i ka bërë pyetje OE të rekomandua lidhur me tenderin jo normalisht të ulët kurse OE i rekomandua me 04.07.2018 ka kthyer përgjigje sqarim se qëndron pranë gjitha çmimeve ndërsa nuk ka dhënë sqarime se si do e realizoj këtë kontratë me këtë çmim të ofruar. Sipas vlerës së ofertuar OE nuk mund mbuloj as pagat e punëtorëve sepse janë kërkuar 31 punëtor, që i bie 31 here 210€, ku për 18 muaj

del rezultati 117,800€. Për këtë arsye OE fitues nuk ka dhënë sqarime se si do realizonte këtë kontratë por vetëm se pajtohen me çmimet e ofruara. Me një shkresë të dërguar nga ky OE me titullin INFORMATË, thotë se: Toiffor shpk ka qenë zbatues i kontratës të datës 14.05.2015 me KK Prishtinë, me titull Mirëmbajtja rrugëve dhe trotuareve të qytetit pjesa III, me numër 61515022211, dhe thotë se kontrata është kryer në përputhje me kërkesat dhe është kryer në sezonin përkatës 14.05.2015 deri me 15.11.2017. Më tuje OE deklaroi se “kjo kontratë ka qenë 149,822.48€ për një vit”, që i bie për tri vite 449,467.44€, që i bie se është më e lirë në vlerë 329,584.45€. Si është e mundur që e njëjta kompani për këtë kontratë të ofroj çmim para tri viteve 449,467.44€, ndërsa për kontratë të ngjashme pas tri viteve të ofroj çmim 119,882.99€, kur dihet se prej 2015 deri tani gjitha shërbime dhe furnizimet kanë shënuar rritje. AK nëse do krahasonte kontratat e vitit paraprak me njëjtin OE do bindej se ky OE ka bërë gabim duke menduar se paramasa dhe parallogaritja duhet plotësuar vetëm për një vit e jo për tri vite dhe plotëson kushtet për çmim jo normalisht të ulët. Kërkojmë nga panelit të aprovoj ankesën 412/18 dhe të behet anulimi i njoftimit për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z.Mekolli deklaroi: AK komuna e Prishtinës ka udhëhequr aktivitetin e prokurimit për: Mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës. Procedura e tenderit për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve ka qenë procedure e madhe dhe e ndarë në gjashtë (6) lot. Për lotin e II-te loto për të cilën ne po diskutojmë sot kanë ofertuar gjithsej tetë (8) OE. Komisioni i vlerësimit, vlerësimin e ofertave të këtij tenderi e ka bërë duke u mbështetur në LPP Nr. 04/L-042 pikërisht në NENIN 1 Qëllimi.

- Në NENIN 1 paragrafi 1 thotë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën me efikasë, me transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike , si dhe
- Në NENIN 6 paragrafi 1 thotë: të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet të përdoren në mënyrë me ekonomike.

Në Njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit kriter për dhënie të kontratës ka qenë çmimi më i lirë. Po ashtu në: Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) kanë qenë të dhënat informatat se:

- Tenderi është i ndarë në lot
- Tenderuesit mund të paraqesin tender për të gjitha lotët,
- Se numri maksimal i pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është 1 (një) dhe

Informata se Në rast se Tenderuesi ofron çmimin më të ulët në më shumë se një (1) Pjesë (Lot) atëherë ai do të shpërblehet me kontratë për Pjesën (Lotin) që ofron çmimin më të ulët të mundshëm për autoritetin kontraktues. Pas kthimit nga OSHP-ja të kësaj lende në rivlerësim, komisioni për rivlerësimin e ofertave po ashtu duke u mbështetur në LPP dhe në NJOFTIMIN nr. 223/2018 i datës 20.06.2018 dhe në rekomandimet

e raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën me nr. 223/18 ka kërkuar nga OE ankues sqarime lidhur me referencat dhe certifikatat e pranimeve të punëve apo shërbimeve andaj e konsideron edhe si oferte të përgjegjshme. Po ashtu komisioni i rivlerësimit të ofertave ka kërkuar nga OE i propozuar për kontratë sqarime lidhur me çmimet abnormalisht të ulëta, si dhe deklarate me shkrim ku deklaroni se në rast se do të shpërbleheni me kontratë ju do të dorëzoni sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 30% të vlerës së kontratës. OE i propozuar për kontratë i jep sqarimet e veta lidhur me çmimet abnormalisht të ulëta ku përpos sqarimeve bindëse deklaroi se qëndron prapa çmimeve dhe se zotohet se do të kryejnë punimet sipas ofertës dhe kushteve të kontratës. Po ashtu OE Toifor jep deklarate me shkrim ku thotë: Deklarojmë se në rast se do të shpërbleheni me kontratë kompania jonë TOIFOR sh.p.k do të dorëzojë sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 30% të vlerës së kontratës në ditën e nënshkrimit të kontratës. Pas të gjitha këtyre Komisioni për rivlerësimin e ofertave propozon edhe për herën e dytë OE Toifor për dhënie të kontratës, ku vlera e ofertës së OE të propozuar për kontratë është me lire se vlera e OE ankues për 126,450.32 euro. Në fund AK Komuna e Prishtinës kërkon nga Paneli Shqyrtues që të aprovohet vendimi i AK për dhënie të Kontratës e të anulohet si e pabazuar ankesa e OE ankues. AK deklaroi se çfarë do vendimi që do të merr Paneli Shqyrtues i OSHP, AK do ta respektoj dhe zbatoj.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z.Bushi deklaroi: Ne kemi shqyrtuar gjitha pretendimet ankimore të cilat janë paraqitur detalisht në ekspertizë. Siç kam cek në raport, OE i rekomanduar ka çmim jo normalisht të ulët, mirëpo sipas par.3 të nenit 61 ngel përgjegjësi e AK-së se nëse bindet të vazhdoj me procedurë, apo nëse nuk bindet sipas par.4 të refuzoj.

Anëtari i panelit shqyrtues z.Pacarizi pyeti përfaqësuesin e OE ankues? A janë edhe katër OE më të lirë se ju në renditje me çmim, dhe a janë të përgjegjshëm këta OE.

Në përgjigje z.Bajrami deklaroi: Ky tender është i ndara në lot, disa prej tyre janë shpall të papërgjegjshëm dhe disa tjerë kanë fituar lot tjera, ndërsa për këtë aktivitet mundet të shpallet fitues OE vetëm për një lot.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues z.Bajrami deklaroi: I propozojmë panelit të aprovoj ankesën tonë të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK z.Mekolli deklaroi: Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklaramentit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin e OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 1 par 1. 2 dhe 3 të LPP-së, paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron ky pretendim ankimor për faktin se AK, ka shpallur ofertën me çmimin më të lirë dhe OE i propozuar ka çmimin 119,882.99 €, ndërsa OE ankues ka çmimin 245,966.49, apo 126,083.50 € (më i lirë se OE ankues).

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës si dhe në ecurinë e këtij aktivitetit të prokurimit vlerëson se autoritetit kontraktues ka përzgjedhur OE “Toifor” për LOT 2, pasi që ky operator ekonomik kishte çmimin më të lirë me dokumentacion të përgjegjshëm. Andaj, autoriteti kontraktues i ka trajtuar të gjithë OE në harmoni me nenin 7 të LPP-së, duke i trajtuar në mënyrë të barabartë.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat të cilat i ka pasur në dispozicion konstaton se autoritetit kontraktues ka respektuar nenin 61 të LPP-së, dhe Rregullat për Tender Jo-normalisht i ulet ku në bazë të tabelës është llogaritur dhe konstatuar se OE ankues i ka plotësuar kushtet se oferta e tij është me çmim Jo-normalisht të ulet.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duhet të ketë 30 punëtor fizik, dhe një inxhinier (dmth gjithsejtë 31 punëtorë), ku sipas kalkulimit paga mesatare për një të punësuarit është 210 €, dhe për 18 muaj (31 punëtorë x 210 € x 18 muaj = 117,180 €) Ku pretendon që çmimi i ofertës të OE “Toifor” është 119,882.99 € minus shpenzimet paneli shqyrtues sqaron se sa i përket çmimit të dhënë këtë obligim e ka Autoriteti Kontraktues ku i ka analizuar të gjitha shpenzimet e OE së rekomanduar për kontratë dhe ka kërkuar sqarime lidhur me çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë “Toifor” shpk ku OE i rekomanduar për kontratë i është përgjigjur se qëndrojnë mbrapa çmimeve të dhëna dhe është pajtuar se sigurimit të ekzekutimit ta rris në vlerë prej 30% të vlerës së kontratës dhe me këtë rast Autoriteti kontraktues është bindur që OE “Toifor” shpk ta rekomandojë fitues.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë, nuk ka dhënë sqarime të hollësishme dhe të detajuara se si do ta realizojë këtë kontratë me çmimet e ofruara ashtu siç parashihet në dispozitat ligjore të LPP-së, dhe akteve nënligjore për prokurim publik, prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të kërkojë edhe një herë sqarime shtesë në lidhje me çmimi e ofruara të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Paneli shqyrtues obligon autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit duhet që ta ketë parasysh paragrafin 4.4 të nenit 4 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

Paneli shqyrtues, obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit duhet që ta ketë parasysh paragrafin 4.4 të nenit 4 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe tu përmbahet në detaje të gjitha kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht ti zbatojë të gjitha dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, dhe ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi e tenderëve ta bëjë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Komuna Prishtinë
- 1x1 OE - "Ve - Mor" shpk - Pejë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.